



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
KANCELARI

Nr. 1647 prot.

Tiranë, më 02.05.2024

**Lënda:** Njoftim mbi rezultatin e verifikimit paraprak për pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin “*Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”.

**Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**TIRANË**

**KËSHILLI I GJYKATËS**

Bazuar në Ligjin nr. 98/2016 “*Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 622, datë 10.12.2020 “*Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*”, Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur*” si dhe në shpalljen nr. 1036 prot., datë 01.03.2024 për pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin 1 (një) “*Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*” në Gjykatën Administrative të Apelit:

Në përfundim të verifikimit paraprak në lidhje me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin “*Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*” kandidatja që plotëson kushtin për fazën e dytë, atë të vlerësimit me shkrim nga Komisioni i Pranimit, është:

- Alketa Gjyshi.

Vlerësimi i kandidatit nga Komisioni i Pranimit do të jetë më datë **16.04.2024, ora 11:00** në Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rruga “Ismail Qemali” nr. 9, Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë.

